



## THIRRJE PËR PJESËMARRËS

### Edicioni V: Laboratori i Debatit Universitar

Në kushtet kur Shqipëria është në procesin e negociatave për anëtarësim, nevojitet që universitetet si prodhues të kërkimit shkencor dhe dijes dhe studentët si profesionistë të rinjë të përfshihen në mënyrë aktive në debatin për politikën zhvillimore të nevojshme që vendi duhet të ndërmarrë në shërbim të objektivave të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Pavarësisht së kësaj nevoje, hapësirat e përfshirjes së studentëve në debatin publik mbi modelin zhvillimor të vendit janë të kufizuara, si rrjedhojë e mungesës së burimeve e vizionit nga institucionet dhe kapaciteteve të limituara të vetë të rinjve për t'u përfshirë në mënyrë efektive në debat.

Në këtë kuadër, Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) vijon traditën e konsoliduar të debatit universitar dhe ka kënaqësinë të lançojë Edicionin e pestë të tij.

#### **Rreth SCiDEV**

SCiDEV (Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim) është një organizatë jofitimprurëse dhe jopartiake e cila ka për qëllim mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social si dhe demokratizimin e vendit dhe rajonit. Për realizimin e këtij objekti SCiDEV, bashkëpunon me aktorë nga shoqëria civile, academia, institucionet dhe biznesi. Katër shtyllat/fushat tona të veprimit janë:

- Demokracia dhe Qeverisja e Mirë
- Media dhe Komunikimi
- Fuqizimi i lidhjeve mes kërkimit shkencor dhe shoqërisë
- Inovacioni dhe transformimi digjital

#### **Historiku i Debatit Universitar ndër vite**

Laboratori i Debatit Universitar u zbatua për herë të parë në vitin 2019, në kuadër të Programit Kombëtar të Debatit Rinor për Zhvillim Social dhe Ekonomik të Shqipërisë, i zbatuar nga Liburnetik në gjimnaze dhe SCiDEV në universitete, me mbështetjen financiare të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Një vit pas edicionit të parë, Laboratori i Debatit Universitar u zgjerua duke shtuar krahas kompeticionit mes universiteteve edhe Fushatën “Nga Fjala tek Veprimi”, një hapësirë ku studentët më të motivuar të programit të advokonin për ndryshime pozitive shoqërore pranë institucioneve përgjegjëse me mbështetjen e mentorëve dhe granteve të vogla.

Përgjatë katër edicioneve SCiDEV ia ka dalë me sukses të:

1. Shtrijë debatin universitar në 14 Fakultete dhe Uniersitete nga 5 qytete të ndryshme të Shqipërisë
2. Trajnojë dhe përfshijë në debat më shumë se 500 studentë.
3. Krijojë një blogun e debatit universitar, i cili përmban më shumë se 100 artikuj të përgatitur nga studentë e pedagogë.
4. Mbështesë 34 studentë e aktivistë me mentorim dhe grante të vogla në kuadër të Fushatës “Nga Fjala Tek Veprimi”.
5. Publikojë 9 dokumente politikash me perspektivë rinore ku janë mbuluar fusha si arsimit, digjitalizimi, qarkullimi i mendjes dhe frenimi i largimit të “trurit” si dhe infrastruktura si mjet për zhvillimin ekonomik të vendit.
6. Zhvillojë për herë të parë Forumin e Debatuesve të Rinj, një platformë e cila përfshiu 30 aktivistë studentorë në draftimin e 4 propozimeve konkrete të cilat u prezantuan dhe u diskutuan me politikbërës nga pushteti qëndror e lokal, sektori i organizatave jofitimprurëse dhe i biznesit si dhe akademia.

## **Rishtë dhe funksionimi i Edicionit V të Debatit Universitar**

Në përvjetorin e pestë të tij, Debatit Universitar do të zgjerohet në të gjitha qytetet e Shqipërisë të cilat kanë Institucione të Arsimit të Lartë. Edicioni i pestë hap dyert për herë të parë për studentët e Universitetit “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan dhe “Eqeqrem Çabej” në Gjirokastrë për t’u bërë pjesë e kompeticionit të Debatit Universitar. Në sinergji me shpalljen e vitit 2023 si viti europian i aftësive, tematikat e debatit universitar do t’i dedikohen rolit të shtetit dhe universitetit në zhvillimin e aftësive të profesionistëve të rinj me qëllim përshtatjen me dinamikën e shekullit XXI.

Në këtë edicion për herë të parë studentëve do t’ju jepet mundësia të aplikojnë në grup të përbërë nga tre debatues dhe të garojnë për të përfaqësuar Universitetin e tyre në kompeticionin e debatit universitar.

Skuadrat debatuese me aplikimin më cilësor do të përzgjidhen për t’u bërë pjesë e Debatit Universitar dhe do të:

1. Marrin pjesë në Programin e Zhvillimit të Kapaciteteve, një cikël prej 3 trajnimesh dedikuar temave dhe formatit të debatit universitar në këtë edicion.

2. Garojnë në nivel Fakulteti/Universiteti për të përfaqësuar Fakultetin/Universitetin e tyre në Maratonën e Debatit Universitar

Skuadrat e përzgjedhura si përfaqësuese të Fakulteteve/Universiteteve të tyre do të marrin pjesë në Maratonën e Debatit Universitar, ku do të përballen me skuadra nga universitetet/fakultetet e tjera pjesëmarrëse në program.

3 skuadrat me numrin më të lartë të pikëve të akorduara nga juria vlerësuese e debatit do të shpallen fituese të debatit universitar. Për skuadrat fituese do të akordohen çmime speciale si dhe do të përzgjidhen për të marrë pjesë në Fushatën “Nga Fjala Tek Veprimi”, ku do të fuqizojnë kapacitetet në kërkim shkencor dhe advokim, do të fuqizojnë ndërlidhje si dhe do të drejtojnë punimet e Forumit të dytë të debatuesve të rinj, ku propozime konkrete për fushën e arsimit, rinisë dhe punësimit do të hartohen dhe diskutohen me politikbërës, akademikë, përfaqësues nga shoqëria civile, media dhe biznesi.

### **Aplikimi dhe kriteret e përzgjedhjes së skuadrave debatuese**

Aplikimi për të marrë pjesë në Edicionin V të Labororit të Debatit Universitar zhvillohet online deri me 10 dhjetor 2023, 23:59.

**Linku i aplikimit:** <https://forms.gle/uHw4R1UsumXjrzz86>

Studentët kanë të drejtë të aplikojnë individualisht ose në grup të përbërë nga 3 studentë. Aplikimet në grup do të vlerësohen me prioritet nga grupi vlerësues i SCiDEV.

Kriteret e përzgjedhjes së grupeve dhe aplikantëve individualë jepen si më poshtë:

1. Skuadra/individit aplikant/e studion në nivelin Bachelor ose Master në një nga fakultetet/universitetet në të cilat do të shtrihet programi.
2. Në rastin e aplikimeve të skuadrave, të gjithë studentët duhet të studiojnë në të njëjtin Fakultet/Universitet. Psh. Skuadrat nga Fakulteti i Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës duhet të përbëhen vetëm nga studentë që studiojnë në një nga programet Bachelor ose Master që ofron fakulteti.
3. Motivimi për t'u bërë pjesë e Labororit të Debatit Universitar dhe Fushatës “Nga Fjala Tek Veprimi” nëse përzgjidhen si fitues të edicionit të pestë.
4. Demonstrimi i angazhimit në çëshje sociale apo studentore.

## Universitetet/Fakultetet në të cilat do të shtrihet Edicioni V i Laboratorit të Debatit Universitar

1. Universiteti i Tiranës
  - Fakulteti i Shkencave Sociale
  - Fakulteti i Drejtësisë
  - Fakulteti i Ekonomisë
  - Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
  - Instituti i Studimeve Evropiane
2. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
3. Universiteti European i Tiranës
4. Universiteti Bujqësor i Tiranës
5. Universiteti “Aleksandër Moisiu’ Durrës
6. Universiteti “Aleksandër Xhuvani’ Elbasan
7. Universiteti “Luigj Gurakuqi’ Shkodër
8. Universiteti “Ismail Qemali’ Vlorë
9. Universiteti “Fan Noli’ Korçë
10. Universiteti “Eqerem Çabej’ Gjirokastër

### Pyetje dhe informacion shtesë

Për çdo pyetje, paqartësi apo nevojë mbi aplikimin, aplikantët mund të kontaktojnë SCiDEV në emailin [info@scidevcenter.org](mailto:info@scidevcenter.org).

Pur t'u njohur mirë më tej me programin e debatit, mund të shqyrtoni [webin](https://debate.scidevcenter.org/) <https://debate.scidevcenter.org/>, në të cilin gjeni paketat kërkimore, përshkrimet e debateve të kaluara, artikujt blog dhe dokumentet e politikave të përgatitura nga aktivistët e Fushatës “Nga Fjala tek Veprimi” ndër vite.

SCiDEV Center

[info@scidevcenter.org](mailto:info@scidevcenter.org)

NA NDIQNI NË

